**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 4458 Prot                                        Shkodër, më 21/02/2025

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt vendimi per miratim " Për miratimin e kërkeses të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr. 2/204,nr.2/699,zk 8593 ,pasurive me nr. 3/733 nr. 3/735 dhe nr. 3/957 zk 8591.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHRODËR**

Të nderuar këshilltarë, Referuar ligjit 139/2015 "Per veteqevcrisjen vendore"të ndryshuar, VKB nr. 60, date 28,12,2020, "Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit Të Keshillit bashkiak Shkoder", bashkengjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt vendimin per miratim: " Për miratimin e kërkeses të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr. 2/204,nr.2/699,zk 8593 ,pasurive me nr. 3/733 nr. 3/735 dhe nr. 3/957 zk 8591".

Bashkëlidhur gjeni:

Projekt Vendim 1 (nje) fletë.

Relacion 3 (tre) fletë.

Shkresë nr 254,datë 12.12.2024 1(fletë)

Shkresë e ASHK nr.9 prot, datë 08.01.2025 1 (një) fletë

Vendim nr.3 datë 24.01.2025 3 (tre) fletë

VKM 350,datë 29.04.2020 1 (një) fletë

Vendim nr.1,datë 27.07.2020 7 (shtatë) fletë.

Urdhër nr.184,datë 06.07.2005 8(tete)

**Duke Ju uruar punë të mbarë!**

**Me respekt.**

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KYETAR**
**Onid BEJLERI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr.__________Prot

Shkodër, më ___.___.2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.______, datë____.____.2025**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESES TË SHOQËRISË TRAJTIMI STUDENTAVE SH.A PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE ME NR. 2/204,NR.2/699,ZK 8593 ,PASURIVE ME NR. 3/733 NR. 3/735 DHE NR.3/957 ZK 8591.**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës ____.____.2025, mbështetur në ligjin 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar neni 9, pika 1.2 germa "a" dhe "c",ligjit Nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar,VKM nr. 350,datë 29.04.2020 "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve" SH.A Shkodër ,nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër",Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",Vendimit nr.1 "Për miratimin e statusit të "Trajtimi i Studentave Sh.A" ,shkrese e ASHK nr.9,prot,datë 08.01.2025,si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI :**

1. Të miratojë kërkesen e Shoqërisë "Trajtimi i Studentave" SH.A për transferimin e pasurive me nr. 2/204; nr.2/699 Zona Kadastrale 8593 si dhe pasurive me nr. 3/733 nr. 3/735 dhe nr.3/957, Zona Kadastrale 8591 .
2. Të ndiqen proçedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi,nga Drejtoria Aseteve dhe Kadastres Urbane,pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Shkodër duke bashkërenduar punën me institucionet përgjegjëse .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KYETAR**

**Onid BEJLERI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**DREJTORIA E ASETEVE DHE KADASTRES URBANE**

Nr. 4458/1 Prot  Shkodër, më 21/02/2025

# RELACION

**PËR MIRATIMIN E KËRKESES TË SHOQËRISË TRAJTIMI STUDENTAVE SH.A PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE ME NR. 2/204,NR.2/699,ZK 8593 ,PASURIVE ME NR. 3/733 NR. 3/735 DHE NR. 3/957 ZK 8591.**

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Shkoder ka paraqitur materialin pranë Këshillit Bashkiak Shkoder,me objekt:
Për miratimin e kërkeses të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr. 2/204,nr.2/699,zk 8593 ,pasurive me nr. 3/733 nr. 3/735 dhe nr. 3/957 zk 8591.

Në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale dhe objektivave të saj,Trajtimi i Studentave Sh.a, shoqëri e transferuar në pronësi të Bashkisë Shkodër me VKM Nr. 350 datë 29.04.2020, Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve" SH.A Shkodër , nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër ", ka vlerësuar të domosdoshme nevojen për transferimin e truallit funksional ku ndodhen ndërtesat e rregjistruara në pasuritë me nr 2/599/2,nr.2/599/1,nr.5/56 Zona Kadastrale 8593 ,nr 3/372 dhe nr.3/734 Zona Kadastrale 8591.
Që nga krijimi i shoqërisë ne viti 2005 bazuar ne statutin e themelimit të shoqërise neni 3, shoqëria është krijuar me kapital themeltar ne vleren 157.323.000 leke ku theksohet që në kapitalin themeltar nuk është përfshire vlera e truallit,bazuar në VKM Nr. 350, "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve" SH.A Shkodër , nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër ","si dhe Vendimit nr 1,datë 27.07.2020 për miratimin e statutit të "Trajtimi i Studentëve Sh.A" Shkodër rezulton se vlera e kapitalit është e njëjta me vleren e momentit të krijimit të shoqërisë.

Për këtë arsye Shoqëria Trajtimi i Studentave Sh.a me shkresen me nr.254,datë 12.12.2024 me lënde "Kërkesë për informacion" drejtuar ASHK Drejtorisë së Pronës Shtetërore ka kërkuar informacion mbi proceduren qe duhet të ndiqet për kalimin e pronësinë të pasurive sipërcituar. Me shkresen nr.9,datë 08.01.2025 me lëndë "Kërkese per plotesim dokumentacioni" Drejtoria e Prones Shtetërore pranë ASHK , ka përcaktuar proçeduren që duhet të ndiqet me qëllim transferimin e pasurive ku nje ndër pikat kërkohet vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e kërkesës së shoqërisë.

Ky propozim vjen në vijim të kërkesës së paraqitur nga ASHK Drejtoria e Pronës Shtetërore nr.9,prot,me datë 08.01.2025 me lëndë "Kërkesë për plotësim dokumentacioni".

Sa me siper i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë propozimin :"**Për miratimin e kërkeses të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr. 2/204,nr.2/699,zk 8593 ,pasurive me nr. 3/733 nr. 3/735 dhe nr. 3/957 zk 8591.**

***Duke ju falenderuar!***

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**
**Z / KRYETAR**
**Onid BEJLERI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**"TRAJTIMI I STUDENTËVE" SH.A SHKODËR**

**NIPT : K 46517001 T**

**Pranë Universitetit " Luigj Gurakuqi"**

**Nr.** 254 **Prot.**

**Tel. 022 24 40-66**

**Shkodër, më** 12.12.**2024**

**Lënda:** Kërkesë për informacion

**AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS (ASHK)**
**DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE**

**Tirane**

Nga verifikimet e bëra tek ASHK për objektet në pronësi të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a Shkodër rezulton se kemi në pronësi vetëm objektet ndërtesë:

nr. pasurie 2/599/2 zona kadastrale 8593,
nr. pasurie 2/599/1 zona kadastrale 8593,
nr. pasurie 5/560, zona kadastrale 8593,
nr. pasurie 3/732, zona kadastrale 8591,
nr. pasurie 3/734, zona kadastrale 8591,

por nuk kemi ne pronesi truallin e këtyre objekteve:

Lagjia Fahri Ramadani, Rruga Jeronim De Rada:
nr. pasurie 2/204, zona kadastrale 8593,
nr. pasurie 2/699, zona kadastrale 8593

Lagjia Kongresi i Permetit, Rruga Isuf Sokoli:
nr. pasurie 3/957, zona kadastrale 8591,
nr. pasurie 3/735, zona kadastrale 8591,
nr. pasurie 3/733, zona kadasteale 8591.

Duke qenë se jemi në kushtet e investimeve, mungesa e pronësisë për sipërfaqet e truallit të sipërcituar është bërë pengesë për vazhdimin e investimeve, kërkojmë nga ana juaj informacion mbi orientimin dhe proçedurat që duhet të ndjekim për regjistrimin e sipërfaqes së truallit të shoqërisë. Shoqëria "Trajtimi i Studentëve" sh.a Shkodër është në pronësi të Bashkisë Shkodër, në bazë të VKM nr. 350, date 29,04,2020 për " Transferimin e pronësisë 100% të aksioneve të Shoqërisë Trajtimi i Studentëve sha Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

**ADMINISTRATORE**
**Sindis SULJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · TRAJTIMI I STUDENTËVE · SHKODËR

Konceptoi: Nirsida Nikshiqi

VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KERKESA
NR. 376 DATE 10.01.2025
DERGUAR NGA:
LENDA: . . . . . . . . . .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
## DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE

Nr 9 Prot.

Tiranë, më 08.01.2025

**Lënda:** Kërkesë për plotësim dokumentacioni.

**BASHKISË SHKODËR**
**Z. BENET BECI**
**KRYETAR**
**SHKODËR**

I nderuar Z. Beci,

Pranë Drejtorisë së Pronave Shtetërore është administruar shkresa juaj nr. 256 prot., datë 12.12.2024, nëpërmjet të cilës kërkohet transferimi në pronësi të Bashkisë Shkodër të truallit të ndërtesave të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" Sh.a e cila ka të transferuar dhe rregjistruar në ASHK vetëm ndërtesat.

Nga verifikimi i dokumentacionit, për vijimin e procedurës së kalimit të sipërfaqeve të truallit lutemi plotësimin e dokumentacionit si më poshtë:

- Vendimmarrja e shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" Sh.a për kalimin e të sipërfaqeve të truallit në pronësi të saj.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë për miratimin e kërkesës së shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" Sh.a.
- Konfirmimin e Prefektit të Qarkut për vlefshmërinë e aktit;
- Planet e Rilevimit për çdo pasuri, sipas modelit të aneksit 4 të VKM nr. 782, datë 07.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale", të cilët duhet të dorëzohen në format shkresor dhe digjital;
- Formularët e inventarizimit të plotësuar me të gjitha të dhënat kadastrale të pasurive;
- Status juridik i pasurive jo më i hershëm se 30 (tridhjetë) ditë (kopje kartele dhe fragment hartë kadastrale).

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**DREJTOR**
**Edmir NUFI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS - DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**
**SHOQËRIA AKSIONERE "TRAJTIMI I STUDENTËVE SH.A"**
**SHKODËR**

**Nr.** 28/3 **prot.**

**Shkodër, më** 24.01.**2025**

# VENDIM

Nr. 3 , datë. 24.01. 2025

**PËR :**
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TE KAPITALIT TË SHOQËRISË TRAJTIMI I STUDENTEVE SHA SHKODER**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë aksionere " Trajtimi i Studentëve sha Shkodër", me aksioner të vetem Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, në mbështjetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, VKM nr. 350, datë 29.04.2020 " Për transferimin e pronësisë 100 % të aksioneve të Shoqërisë trajtimi i Studenteve sha Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomise, tek Bashkia Shkodër", ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, ligji nr. 20/2020 "Per perfundimin e proceseve kalimtare te pronesise ne Republiken e Shqipersise", Akti i themelimit dhe Statuti i Shoqerise;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin, zmadhimin e kapitalit te Shoqerise.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi deri ne regjistrimin e pasurise truall.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË AKSIONERE "TRAJTIMI I STUDENTËVE SHA SHKODËR**

**KRYETAR**

**BENET BECI**

5

VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KERKESA
NR. 6137 DATE 5.5.202
DERGUAR NGA:
LENDA: . . . . . . . . . . .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
ZYRA E TITULLARIT

# VENDIM

**Nr. 350, datë 29.4.2020**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "TRAJTIMI I STUDENTËVE", SH.A., SHKODËR, NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TE BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve", sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

Nr. 100.
dt. 28.07.20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E "TRAJTIMI I STUDENTEVE SH.A.
SHKODËR

Nr.10705 Prot

Shkodër, më 27.07.2020

# VENDIM

**Nr. 1, datë 27.07.2020**

## "PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË "TRAJTIMI I STUDENTËVE" SH.A. SHKODËR"

Asambleja e Përgjithshme e "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Shkodër, me aksioner të vetëm Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, VKM nr.350,date 29.04.2020 për "Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimimi studentave" sha Shkodër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër", bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 119, datë 13.05.2020 "Mbi zbatimin e VKM nr.350, datë 29.04.2020 për "Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimimi studentave" sha nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër"

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Statutin e "Trajtimi i Studentëve" Sh.A. Shkodër.

2. Ngarkohet administratori i shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" Sh.A., për zbatimin e këtij vendimi dhe për depozitimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E "TRAJTIMI I STUDENTËVE" SH.A. SHKODËR**

**BASHKIA SHKODER**

**KRYETAR**
**VOLTANA ADEMI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr. 350, datë 29.4.2020

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "TRAJTIMI I STUDENTËVE", SH.A., SHKODËR, NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TE BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve", sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Copyright 2020 - www.ligjet.org

STATUTI

I SHOQËRISË ANONIME

"TRAJTIMI I STUDENTËVE" SH.A. SHKODËR

**Në këtë statut dispozitat ligjore janë:**

- Ligji nr.9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" , i ndryshuar
- Ligji 139/2015``Per veteqeverisjen vendore``, i ndryshuar,
- VKM nr.350, date 29.04.2020 për 'Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë 'Trajtimimi studentave' sha Shkodër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër'
- "Statuti" është statuti i shoqërisë;

## KREU I

## THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

### Neni 1
### Data e Themelimit, Emri Themeluesit dhe Transferimi

1.1 Me 18.07.2005, themeluesit, kanë krijuar një shoqëri aksionare me emrin "Trajtimi i Studentëve, Shkodër" Sh.A.

1.2 Themeluesi i shoqërisë është:
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë, e përfaqësuar nga titullari i saj, me Adresë: Sheshi Skenderbej, Tiranë

1.3 Me VKM nr.350, dt. 29.04.2020 për 'Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë 'Trajtimimi studentave' sha Shkodër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër', shoqëria transferohet në pronësi të Bashkisë Shkodër, përfaqësuar nga Kryetar i Bashkisë, Shkodër ne cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme.

### Neni 2:
### Objekti

2.1 Trajtimi i studentëve me ushqim, fjetje dhe shërbime të tjera.

**Neni 3:**
**Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4:**
**Selia e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Adresën: Rruga "Jeronim De Rada", pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër.

## KREU II

## KAPITALI

**Neni 5:**
**Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 157.323.000 lekë, i ndarë në 157.323 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1 000,00 lekë secili. Aksionet e themeluesit në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

5.2 Bashkia Shkodër zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë.

a. Lloji i kontributit: Në natyrë dhe në para:
b. Numri i aksioneve është 157.323 dhe
c. Vlera nominale e aksionit është 1 000.00 lekë.

5.3 100% e vlerës së kontributeve në para e cila është në gjendje në llogaritë bankare të ish ndërmarrjes shtetërore kalon në llogari të shoqërisë anonime Sh.A "Trajtimi i Studentëve" Shkodër. Kontributet në natyrë do të kalojnë për llogari të Shoqërisë përpara rregjistrimit.

**Neni 6:**
**Rregjistri i aksioneve**

6.1 Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

6.2 Administratori / ët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj cdo aksionari apo cdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin on-line të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1të këtij neni, nga administratori i ngarkuar me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve.

## Neni 7:
## Mënyra e fitimit dhe kalimit të aksioneve

7.1 Aksionet e shoqërisë aksionare dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjêt:

a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë, në castin e formimit të shoqërisë
b) Shitblerjes
c) Trashëgimisë
d) Dhurimit
e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

7.2 Aksionet e të drejtat e fituara si me sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçem të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar.

## Neni 8:
## Zmadhimi i kapitalit Themeltar

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohen duke emetuar rishtazi, kundrejt kontributeve të reja. Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqeritë tregtare``, të ndryshuar.

8.2 Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKB.

8.3 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

8.4 Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të të gjithë aksionarëve.

8.5 Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, Asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

**Neni 9:**
**Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

9.1 Kapitali i regJistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", të ndryshuar.

9.2 Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", të ndryshuar.

9.3 Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh. Kapitali i regJistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

## KREU III
## ORGANET E SHOQËRISË

**Neni 10 :**
**Organet e shoqërisë**

10.1 Shoqëeria është strukturur sipas sistemit me dy nivele.

10.2 Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e përgjithshme
2. Këshilli mbikëqyrës
3. Administratori/administratorët

**Neni 11:**
**Asambleja e Përgjithshme**

11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë.

11.2 Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendor", i ndryshuar dhe Ligjin nr.9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar

11.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet ën selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga kryetari i asamblesë së përgjithshme, këshilli mbikqyrës, administratori i shoqërisë. Mbledhja mund të thirret gjithashtu nga audituesi ligjor i autorizuar, në rastet kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

11.4 Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

11.5 Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet njoftimit me shkresë/ njoftim nëpërmjet postës elektronike.

11.6 Njoftimi me shkresë/postë elektronike dhe rendi i ditës u dërgohet të gjithë aksionerëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Në njoftimin që duhet t'i shkojë çdo anëtari të Asamblesë së Përgjithshme, apo të njihet prej çdo anëtari, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së saj, përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja dhe rendi i ditës.

11.7 Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme, që thirret në mënyrë të pa rregullt është absolutisht i pa vlefshëm.

**Neni 12:**
**Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme**

12.1 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a. përcaktimin e politikave tregtare;
b. ndryshime të statutit;
c. emërimin e shkarkimin e administratorëve
d. emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikqyrës
e. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
f. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
g. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
i. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
j. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera administratorëve;

l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
n. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

12.2 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "g" dhe "h" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

12.3Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
c) investime;
d) vendimet për riorganizimi dhe prishjen e shoqërisë.

12.4Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**Neni 13:**
**Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

13.1Asambleja e përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit te parashikuar nga neni 144 i ligjit nr.9901, date 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar.

13.2Gjatë mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

13.3Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar. Nëse asnjë prej administratorëve nuk dëshiron të caktohet si kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si kryetari të mbledhjes. Administratori ose anëtari i Këshillit të mbikëqyrës pavarësisht se nuk është aksionar, ka të

drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

## Neni 14
## Kuorumi

14.1Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të ligjit nr.9901, date 14.04.2008''Per tregtaret dhe shoqerite tregtare'',të ndryshuar, Asambleja e përgithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të ligiit nr. 9901, date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", të ndryshuar.

14.2Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 15
## Marrja e vendimeve

15.1Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të aksionarëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti.

## Neni 16
## Këshilli Mbikëqyrës

16.1Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

16.2Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të ligjit nr.9901, date 14.04.2008''Per tregtaret dhe shoqerite

tregtare``, të ndryshuar, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit mbikëqyres mund të rizgjidhen.

16.3Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori / ët;
b) Të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
c) Të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
d) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
e) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
f) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

16.4Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të ligjit nr.9901, date 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar , Këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të prishet ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

### Neni 17
### Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

17.1Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë, derisa Asambleja e përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e këtyre mbledhjeve.

17.2Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", të ndryshuar.

17.3Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikim përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtari në momentin e emërimit.

17.4Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit mbikëqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit mbikëqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes.

17.5Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e kryetarit do të jetë vendimtare.

## Neni 18
## Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

18.1Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të proçesverbaleve:

1. Të gjithë takimeve te Këshillit mbikëqyrës
2. Të gjitha mbledhjeve të Këshillit mbikëqyrës, përfshirë edhe emrat e administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

## Neni 19
## Largimi i anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës

19.1Detyra e anëtarit të Këshillit mbikëqyrës përfundon në rast se:

a) Personi pushon së qeni anëtar i këshillit mbikëqyrës në bazë të dispozitave të ligjit nr.9901, date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", të ndryshuar duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
b) Humbet zotesine juridike per te vepruar
c) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë
d) Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit mbikëqyrës në mbledhje e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e përgjithshme, me propozim të Këshillit mbikëqyrës vendos ta shkarkojë nga detyra.

## Neni 20
## Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet e Administratorit/rëve

20.1Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet.

Administratorët e shoqërisë mund të riemërohen. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

20.2Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i Këshillit të mbikëqyrjes të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të mbikëqyrjes të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm.Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të ligjit nr. 9901, date14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", të ndryshuar.

20.3Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

a) Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
c) Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
d) Të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të mbikëqyrjes për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgiithshme;
e) Të krijojnë një sistem paralajmërimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
f) Të kryejnë regiistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
g) Të raportojnë përpara Këshillit mbikëqyres për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
h) Të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

20.4 Detyrat, që i caktòn ligji nr.9901, datë 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar Këshillit mbikëqyres, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

20.5Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të ligjit nr.9901, date 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e Këshillit mbikëqyres.

20.6Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

20.7 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

a) Personi nuk është më administrator në bazë të dispozitave të ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të ligjit nr.9901, date 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar

i.Humbet zotesine juridike per te vepruar

ii.Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë

b) Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit mbikëqyrës në mbledhjet e administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos të shkarkojë nga detyra.

20.8 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## KREU IV
## DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

### Neni 21
### Dividendët

21.1Në përputhje me dispozitat e ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

21.2Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve t periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

21.3Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

21.4Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga asambleja e përgjithme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë e detyruar që ta paguajë atë.

**Neni 22:**
**Kalimi i fitimeve në Kapitalin Themeltar**

22.1 Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i ligjit nr.9901, date 14.04.2008``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare``, të ndryshuar, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividend preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

## KREU V
## DISPOZITA KALIMTARE

**Neni 23**
**Prishja dhe likuidimi**

23.1 Prishja dhe likuidimi i shoqërisë bëhet në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", të ndryshuar.

**Neni 24**
**Mosmarrëveshje**

24.1 Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë gjykata kompetente ku ndodhet selia e shoqërisë.

Ky statut hyn në fuqi, menjëherë, me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

**PËR ASAMBLENË E PËRGJITHDSHME TË "TRAJTIMI I STUDENTËVE" SH.A SHKODËR**

**VOLTANA ADEMI**

Kryetare e Bashkisë Shkodër

(Aksionari i vetëm i Shoqërisë)

Shkodër, 27.07.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

STATUTI

Nr 62 Prot
12/07/05

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

URDHER

Nr. 184, Date 6.7.2005

PER
TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE "TRAJTIMI I STUDENTEVE" SHKODER, NE SHOQERI ANONIME "TRAJTIMI I STUDENTEVE" SH.A, SHKODER

Drejtuar: Ndermarrjes "Trajtimi i Studenteve" - SHKODER

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne baze te nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne Shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore;

URDHEROJ:

1. Transformimin e Ndermarrjes "Trajtimi i Studenteve" Shkoder ne shoqeri te formes anonime "Trajtimi i Studenteve" Sh.a Shkoder.
2. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqorivee te Vogla dhe te Mesme te ndjeke depozitimin e akteve te mesiperme ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere

Anastas ANGJELI
MINISTËR

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
*Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme*

Nr. 105 /Prot

Tirane date 6 .07.2005

# KERKESE

## PER REGJISTRIMIN E SHOQERISE TREGTARE ANONIME SI PERSON JURIDIK

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr.7926, date 20.04.1998 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me ligjet perkatese, kemi krijuar shoqerine anonime "Trajtimi i Studenteve" Shkoder , me aksioner te vetem shtetin te perfaqesuar nga Ministri i Ekonomise dhe me objekt veprimtarie: Furnizimi dhe trajtimi i studenteve me ushqim , fjetje dhe sherbime te tjera .

Antare te keshillit te pare mbikqyres jane:
- Z. Vladimir Pasku
- Z. Shyqyri Llaci
- Zj. Valentina Murashi

Ne baze te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite tregtare", kerkojme nga ana juaj regjistrimin e Shoqerise si person juridik.

Anastas ANGJELI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____._____.2005, ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore, Ministri i Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

VENDOSI:

1. Te krijoje Shoqerine Anonime "Trajtimi i Studenteve" Sh.a Shkoder me kapital 100% shteteror.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Furnizimi dhe trajtimi i studenteve me ushqim , fjetje dhe sherbime te tjera .
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Shkoder. Ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 157,323,000 leke ndare ne 157,323 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.
5. Shoqeria ka nje zgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:

   Z. Vladimir Pasku
   Z. Shyqyri Llaci
   Zj. Valentina Murashi

7. Ndertimi, organizimi dhe fuksionimi i Shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE

Anastas ANGJELI

MINISTER

STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME

NENI 1
Emertimi dhe selia

Shoqeria Anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes shteterore "Trajtimi i Studenteve" Shkoder
Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet: "Trajtimi i Studenteve Sh.a Shkoder
Selia e Shoqerise eshte ne adrese: Shkoder

NENI 2
Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:
8. Furnizimi dhe trajtimi i studenteve me ushqim , fjetje dhe sherbime te tjera .

NENI 3
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 157,323,000 leke. Numri i aksioneve eshte 157,323. Vlera nominale e aksionit eshte 1,000 leke. Ne kapitalin themeltar nuk eshte perfshire vlera e truallit, gje e cila do te behet ne nje kohe te dyte.

NENI 4
Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi.

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise, ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

NENI 5
Organet drejtuese te Shoqerise

Organet drejtuese te Shoqerise jane:
1) Keshilli Mbiqyres
2) Drejtoria

NENI 6
Keshilli Mbikqyres

- Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 (tre) antare. Antaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise.
- Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Antaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Antaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne Shoqeri.
- Nese nje ose disa vende te antareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose dorehegje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Antari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesimin e nje antari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

Antaret e keshillit mbikqyres te moshes 65 (gjashtedhjete e pese) vjec nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet, antari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 7
Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh ndermjet antareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar, te cilet therrasin mbledhjen e keshillit dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithe kohen e mandatit te tyre dhe mund te rizgjedhshem.

Keshilli Mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte antareve te tij. Ne rast mungese se pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendeskryetari.

NENI 8
Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij te zevendeskryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhjete) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e antareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje atehere antaret duhet te therrasin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afatnese antaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate.

Cdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e Shoqerise ose ne cdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e antareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesmarrjes ne mbledhjen e tij i cili nenshkruhet nga antaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi nga kryetari ose zevendes kryetari.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendeskryetari i keshillit mbikqyres.

NENI 9
Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli Mbikqyres emeron drejtorine. Keshilli cakton njerin prej antareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e antareve te drejtorise, keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli Mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te ketij statuti.
- Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikime dhe kontrolle qe ai i cmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore ne qellim verifikimi dhe kontrolli.

Keshilli Mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise lidhur me keto ceshtje:

a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afat mesem dhe afat gjate te Shoqerise.
b). Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te Shoqerise.
c). Hapja e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te Shoqerise.
d). Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te Shoqerise.
e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesemarrjen ne kapitalin e Shoqerive te tjera
f) Marrjen e huave afatmesme dhe afatgjate.
g). Si dhe cdo gje tjeter qe ne baze te Ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.

NENI 10
Shperblimi i antareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i antareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne vendim te Keshillit te Ministrave.

NENI 11
Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria, e cila mund te perbehet nga nje ose disa antare. Numri i antareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakort jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe antareve te ketij keshilli.
- Antaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne Shoqeri. Nese nje antar i keshillit mbikqyres emerohet antar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet antar i drejtorise ose drejtor ne me shume se nje Shoqeri. Antaret e drejtorise mund te emerohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i antarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Antaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe 4 (kater) vjecare. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Antaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhjete e pese) vjec. Antari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhjete e pese) vjec konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e antareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne perputhje me VKM ne fuqi.

NENI 12
Kompetencat e drejtorise.

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te drejtorise.
- Ne marredheniet me te tretet Shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruar nga antari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin veprimtarise se Shoqerise, pervec rastit kur Shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se Shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke patur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

- Akte me te cilat Shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga antari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e antareve te saj. Ne rast barazimi votash, vota e antarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise, te cilen e miraton keshilli mbikqyres.
- Drejtoria harton rregulloren e brendshme te shoqerise dhe e miraton ne keshillin mbikqyres.

NENI 13

Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe drejtorise ose te nje antari te keshillit mbikqyres

Cdo marreveshje ndermjet Shoqerise dhe antareve te drejtorise ose nje antari te keshillit mbikqyres qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres. Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe nje Shoqerie tjeter, kur nje antar i keshillit mbikqyres eshte dhe antar i keshillit mbikqyres te nje Shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te Shoqerise qe kryhen ne kushte normale.
Antari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesa e ketij neni te statutit. Antari i ineresuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14

Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i Shoqerise ushtrohet nga eksperte kontabel i autorizuar te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga date e regjistrimit ne Rregjistrin Tregtar deri me date 31 dhjetor.

NENI 16

Inventari–llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e Shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit.

Rezulati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem. Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga

...t per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme, kur kjo rezerve arrin ne 1/10 (nje te ...en) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje aresye cfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur ...ne 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit.
...rdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise.

NENI 18

Emerimi i antareve te pare te keshillit mbikqyres.

...ji antare te pare te keshillit mbikqyres:

Z. Vladimir Pasku
Z. Shyqyri Llaci
Zj. Valentina Murashi

NENI 19

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Eksperti i pare i autorizuar emerohet:

1. Eftali Qirjaqi

NENI 20

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise me cilesine e aksionerit te vetem.

NENI 21

Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar drejtori i shoqerise do te jete drejtor i ish ndermarrjes shteterore.
Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise vec per shkaqe te perligjura.

NENI 22

Per ofare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per Shoqerite tregtare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE – MINISTRIA E EKONOMISE

Anastas ANGJELI
M I N I S T Ë R